



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
AGJENCIA PËR ADMINISTRIMIN E TREGJEV

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ , _____ , 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Agjencisë së Prokurimit Publik,
Blvd: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

Drejtuar: Operatorit Ekonomik "ARTEO 2018" sh.p.k., me NIPT - L82523203F, me ofertë ekonomike me vlerë totale 2.797.800 (dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, me adresë: Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr. 303.

Procedura e prokurimit/lotit: "Procedurë e Hapur e thjeshtuar- Shërbim"

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF: 17095-08-27-2024

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Eja në Bahçe"

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti):

Buletini nr. 40, datë 22 Korrik 2024

Nr. REF: 13429-07-17-2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. Operatori Ekonomik, ARTEO 2018 sh.p.k., me NIPT - L82523203F, me ofertë ekonomike me vlerë totale 2.797.800 (dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH, me adresë: Elbasan Lagjja Luigj Gurakuqi, Bulevardi Aqif Pasha, Hotel Skampa, kati 5 nr. 303.**
- 2. Operatori Ekonomik, Shoq. Njerez dhe Ide me NIPT K92108452D, me adresë: rruga Perlat Rexhepi, hyrja 1, ap 13 Tiranë, me ofertë ekonomike me vlerë totale 2.200.000 (dy milionë e dyqind mijë) lekë pa TVSH.**

Është s'kualifikuar operatori i mëposhtëm:

- 1. Operatori Ekonomik, Shoq. Njerëz dhe Ide, me NIPT – K92108452D , - skualifikohet, Gërma “e”, pika 1 – O.E Njerëz dhe Ide ka paraqitur një vërtetim nga FSHU me nr. 1014 prot., datë 19.07.2024, në të cilin vërteton se nuk është debitor përse i përket mujit Qershor 2024. Ky dokument nuk pasqyron plotësimin e kriterit për pagesat e energjisë elektrike sipas kushteve dhe afateve të tyre për muajin Korrik 2024. Në këto kushte OE Njerëz dhe Ide nuk e plotëson këtë kërkesë.**
- 2. Pika 2.2.1** Në dokumentin e paraqitur për vërtetimin e xhiros, nuk pasqyrohet vlera e xhiros së realizuar, dhe si rezultat dokumenti është i pamjaftueshëm për të plotësuar kushtin e kapacitetit ekonomik – financiar për realizimin e xhiros në nivelin e vlerës 40% të fondit limit të procedurës së prokurimit. Në deklaratën e paraqitur nga OE Njerëz dhe Ide, në lidhje me arsyetimin e mosparaqitjes së nivelit të xhiros, theksojmë se koncepti i xhiros së realizuar është i ndryshëm nga ai i fitim të realizuar gjatë periudhës ushtrimore. Në këto kushte OE Njerëz dhe Ide nuk e plotëson këtë kërkesë.
- 3. Pika 2.6** O.E Njerëz dhe Ide ka paraqitur për plotësimin e këtij kriteri dy fatura të lëshuara ndaj Bankës Credins, të cilat vijnë si rezultat i sponsorizimeve të përfituara nga kjo bankë. Përshkrimi i shërbimit në faturë është “Financim për projektin ...”. Në këto kushte OE Njerëz dhe Ide nuk vërteton plotësimin e këtij kushti, për aftësi teknike dhe profesionale për realizimin e kontratave të ngjashme në vlerë jo më të vogël se 20% e fondit limit të procedurës së prokurimit.
- 4. Pika 2.9.1** O.E Njerëz dhe Ide ka plotësuar Formularin Përmbledhës së Vetdeklarimit sipas Shtojcës nr. 9 në të cilin pasqyrohet se disponon mjete për përmbushjen e këtij kushti. Gjithashtu ka paraqitur deklaratën në të cilën merr përsipër shërbimin e transportit për të gjithë kohën e realizimit të aktivitetit sipas përcaktimeve në Shtojcën nr. 5. Bashkëngjitur me deklaratën është edhe kopje e kontratës së shërbimit me të gjithë dokumentacionin e mjetit. Në pikën 3.1 të kontratës shprehet se: “kjo kontratë hyn në fuqi në 06.09.2024 dhe do jetë e vlefshme deri për një periudhë 1 mujore”, ndërsa në pikën 7.2 të kontratës shprehet se: “palët bien dakort të rinovojnë këtë kontratë për një tjetër afat kohe, por të gjitha palët (secila palë) duhet të shkruajë njoftimin të paktën 30 ditë para përfundimit të saj, për çdo rinovim”. Në këto kushte kur OE Njerëz dhe Ide nuk ka paraqitur miratimin për shtyrjen e afatit të kontratës arrihet në konkluzionin se: Periudha e kontratës së qirasë së mjetit nuk mbulon periudhën kohore për realizimin e aktivitetit. Në këto kushte OE Njerëz dhe Ide nuk e plotëson këtë kërkesë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Operatori Ekonomik “ARTEO 2018” sh.p.k., me NIPT - L82523203F**, me ofertë ekonomike me vlerë totale **2.797.800 (dy milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Agjencisë për Administrimin e Tregjeve (AAT), sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Konc: I.Madhi